



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjeno/Prodato Received/Delivary	25.08.2022	viti god. year	2
Organ/Njësia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSK	4975/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.491/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani anëtar, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1639/2021 të datës 27.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentin për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.775/2019 të parashtruar me datë 24.12.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë,

kundër Vërejtjen me shkrim dhe mbishkrim të datës 26.11.2019 numër protokoli 2728/2019, e shqiptuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.08.2022 mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa e ankuesit me numër Anr.775/2019 e datës 24.12.2019.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomi, sipas Akt Emërimit të datës 31.03.2016,, në pozitën "Zyrtar i lartë për Gjeokimi", me datë 29.11.2019 ka pranuar Vërejtjen me shkrim dhe mbishkrim të datës 26.11.2019 numër protokoli 2728/2019, e shqiptuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë/Drejtori i Shërbimit Gjeologjisë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomi, për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes në shërbimin civil, nga ana e ankuesit.

Kundër vërejtjes me shkrim dhe mbishkrim të datës 26.11.2019 numër protokoli 2728/2019, ankuesi me datës 24.12.2019 ka parashtruar ankesë në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokoli 5938/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.01.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, të cilët me datës 20.01.2020 ka dhënë përgjigje ne ankesë me shkresat e bashkangjitura prej 1/28 faqe.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesi më datë 16.01.2020 është njoftuar për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamentin për Çështje Administrative me datë 31.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.321/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 16.01.2020 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit, mirëpo Këshilli gjatë kësaj kohe ka qenë jofunksional dhe me datë 07.07.2021 ankuesi është njoftuar nuk është shqyrtuar ankesa duke e udhëzuar ankuesin që të vazhdoj procedurën e mëtejme në konflikt administrativ, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamentin për Çështje Administrative me datë 06.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1639/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 07.07.2021 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Aktgjykimi me numër A.nr.1639/2021 i datës 27.07.2022 i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, i protokolluar nr. 4355/2022 në Këshill me datës 27.07.2022, me numër të ankesës Anr.491/2021 sipas Aktgjykimit Anr.321/2021 të datës 31.05.2021 i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative i protokolluar me nr.2827/2021 në Këshill me datës 02.06.2021; Parashtrësë e datës 12.08.2022 nr. Protokolli 4690/20222 për KPMSHK, e përfaqësuesit të autorizuar avokati dhe lidhur me shqyrtimin e ankesës se ankuesit sipas Aktgjykimeve, dhe Parashtrësë e datë 12.07.2021 nr.Prtokollli 3636/2021; Ankesa A.nr.775/2019 e datës 24.12.2019 me numër protokollli 5938/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 03.07.2019; E-maili i datës 08.07.2019 i z.E.Q., Përgjigje në Email i datës 09.07.2019 i z.F.S.; E-maili i datës 11.07.2019 ; E-maili i datës 16.07.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 11.08.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 11.11.2019 i z.F.S; E-maili i datës 11.11.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 15.11.2019 i z.F.S; E-maili i datës 15.11.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 22.11.2019 i z.F.S; E-maili i datës 025.011.2019 i z.E.Q; Vërejtje me shkrim e datës 26.11.2019 nr.protokollli2728; E-maili i datës 24.04.2019 për caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e sinjalizuesit; E-maili i datës 03.07.2019 i z.F.S; E-maili i datës 11.11.2019 nga AKK; komunikimet e përsëritura: E-maili i datës 08.07.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 09.07.2019 i z.F.S; E-maili i datës 08.07.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 16.07.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 09.07.2019 i z.F.S; E-maili i datës 08.11.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 11.11.2019 i z.F.S; E-maili i datës 15.11.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 08.11.2019 i z.E.Q drejtuar AKK për refuzim për caktimin e tij të detyres; E-maili i datës 11.11.2019 i z.F.S per AKK; E-maili i datës 08.11.2019 i z.E.Q; E-maili i datës 11.11.2019 i z.E.Q; E-maili i datës

29.11.2019 për z.E.Q lidhur me vërejtjen me shkrim; përgjigje ne ankesë e datës 20.01.2020 nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Akt emërimi i ankuesit i datë 31.03.2016.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Ligji Nr. 04/L-114 për Zyrat e Publikë ka hyrë në fuqi më muajin shtator 2019 i cili me nenin 85 ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, mirëpo me datë 19.11.2019 është pezulluar zbatimi i këtij ligji, me masë të përkohshme nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rrjedhimisht me pezullimin e Ligji Nr. 04/L-114 për Zyrat e Publikë, të aplikueshme nga kjo kohë kanë qenë dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe rregulloret përkatëse që kanë derivuar nga ky ligj.

Në bazë të Vërejtjes me shkrim dhe mbishkrim të datës 26.11.2019 numër protokolli 2728/2019, të shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për ankuesin, e njëjta është shqiptuar mbi bazën e Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse këtë kohë qenë të aplikueshme dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe rregulloret përkatëse që kanë derivuar nga ky ligj, atëherë çdo e drejtë dhe detyrim i nëpunësit civil është dashur të ndjekjen procedurat sipas këtyre dispozitave.

Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës sipas të cilit me nenin 81 është përcaktuar se: *1.Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ndërlidhur me këtë, neni 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka specifikuar se: nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës”, e mbi këtë bazë ligjore rrjedhë se ankuesi në rast të pakënaqësisë lidhur me masën disiplinore të shqiptuar është dashur që të ushtroj fillimisht ankesë të brendshme gjegjësisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, e me tej në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës siç parashihet edhe me dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: “1.Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës. 2.Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike”, si dhe duke ju referuar nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas shkresave të lëndës dhe në bazë të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi, me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 24.12.2019 në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës tek organi i punësimit, siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përcaktohet se: „*Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit nëse me ligj te veçanta nuk është përcaktuar ndryshe*”, duke u ndërlidhur me dispozitat e nenit 3 paragrafi 6 të Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rrjedhimisht ankuesi nuk ka parashtruar ankesë sipas nenit 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, kështu që ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pajeluar.

Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.491/2021

Aydyl BEKTESHI

Bektashi
Procesmbajtës

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë së Ekonomisë;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

